



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.367/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Komuna Prishtinë, paraqitur kundër Ndërmarrjes publike "Pallati i Rinisë dhe Sporteve", me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të refuzimit të kërkeses për shfrytëzimin e salles së sporteve, për mbajtjen e aktivitetit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, raundi i dytë për Kryetar të Komunës, që do të mbahet me 09 Nëntor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 05.11.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET e PABAZUAR, ankesa ZL.Anr.367/2025 datë 03.11.2025, e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër Ndërmarrjes publike "Pallati i Rinisë dhe Sporteve", me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të refuzimit të kërkesës për shfrytëzimin e salles së sporteve, për mbajtjen e aktivitetit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, raundi i dytë për Kryetar të Komunës, që do të mbahet me 09 Nëntor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 03.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.367/2025, e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, në të cilën thekson se me datë 31.10.2025 ka kërkuar shfrytëzimin e sallës së sporteve në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë, për mbajtjen e një aktiviteti të fushatës zgjedhore më 8 nëntor 2025, ora 20:00. Tutje parashtuesi i ankesës thekson se kërkesa është miratuar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) i Komunës së Prishtinës, në pajtim me nenin 4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës dhe Deklarimin Financiar, e cila parasheh se subjektet politike mund të mbajnë tubime në institucione sportive pas miratimit të KKZ-së dhe nëse nuk pengohet puna e rregullt e institucionit, Pavarësisht këtij miratimi, znj. Albrie Kastrati, zyrtare përgjegjëse në ndërmarrjen publike "Pallati i Rinisë dhe Sporteve", ka refuzuar me email më 31.10.2025 dhënien e sallës për orën 20:00, duke pretenduar se "salla është e zënë gjithë ditën për Turneun Ndërkombëtar "Adem Jashari" në xhudo". Sipas informacioneve zyrtare, turneu përfundon në orën 16:00, prandaj nuk ekziston asnjë arsye objektive për refuzimin e kërkesës sonë. Për korrektësi, sërish i jemi drejtuar znj. Kastrati duke e paralajmëruar për mundësinë e ushtrimit të ankesës në PZAP, por nga e njëjta, deri sot, me dt.03.11.2025, nuk kemi marrë përgjigje.

Ky veprim përbën pengesë të paarsyeshme dhe ndërhyrje politike të pushtetit lokal në procesin zgjedhor, si dhe shkelje të dispozitave të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, nenet 4 dhe 6, dhe të nenit 36 të Ligjit Nr.08/1-228, që ndalon çdo formë diskriminimi apo pengimi të subjekteve politike gjatë fushatës. Refuzimi i një institucioni publik ndaj një subjekti të certifikuar, pas miratimit nga KKZ minon parimin e barazisë së garës zgjedhore dhe cenon ushtrimin e lirë të aktivitetit politik në hapësira publike. Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkojmë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa që: të konstatojë se veprimi i znj. Albrie Kastrati përbën shkelje të dispozitave të Rregullores 07/2024 dhe të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme; të urdhërojë ndërmarrjen publike "Pallati i Rinisë dhe Sporteve" që të mundësojë mbajtjen e aktivitetit të miratuar nga KRZ më 8 nëntor 2025 në orën 20:00; të njoftojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për marrjen e masave ndaj palës përgjegjëse dhe të parandalojë përsëritjen e shkeljeve të tilla gjatë periudhës së fushatës. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës si provë komunikimet përmes emaili me zyrtaren përgjegjëse të Pallatit të Rinisë dhe sporteve si dhe formularin e njoftimit për mbajtjen e tubimit politik.

Në përgjigjen në ankesë nga zyrtarja përgjegjëse Alberie Kastrati përmes emaili theksohet se se me datë 8 nëntor janë anuluar edhe disa kërkesa të tjera, jo vetëm ajo e Lëvizjes Vetëvendosje, dhe se arsyeja e anulimit të këtyre kërkesave është se në atë datë zhvillohet një aktivitet ndërkombëtar në xhudo, i cili është gjithëditor. Me organizatorin e aktivitetit jerni koordinuar në këtë menyrë që në fillim të rezervimit të datës 8 nëntor, andaj në bazë të rregullores se brendshme nuk lejohen të zhvillohen dy aktivitete në të njëjten kohë. Përgjigjes në ankese ka bashkangjitur edhe komunikimit në mes zyrtares përgjegjëse Alberie Kastratit dhe klubit të xhudos "Polic", në të cilin kanë konfirmuar përdorimin e palestrës për tërë ditën e shtunë, më 08.11.2025, si dhe kërkesën e klubit të xhudos "Polic, të paraqitur pranë Drejtorisë së Sportit Komuna Prishtinë.

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror Zgjedhor sqaron se nga informacioni që kemi pranuar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve në Komunën e Prishtinës, subjekti politik LVV me datën 17.10.2025, ka dorëzuar formularin për njoftimin e tubimit politik për tubimin e datës 08 nëntor 2025, sipas kërkesave ligjore, ku edhe i ka bashkangjitur përgjigjes formularin e njoftimit për mbajtjen e tubimit politik të miratuar nga KKZ Prishtinë, si dhe emailin e datës 28.10.2025 të datës nga ana e LVV-së, përmes të cilit, është njoftuar për orën e saktë të zhvillimit të tubimit me 08.11.2025.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shqyrtimit të ankesës dhe përgjigjes në ankesë të parashtruar nga zyrtarja përgjegjëse e ndërmarrjes publike Pallati i Rinisë dhe Sporteve, si dhe përgjigjes nga KQZ, vlerësoj se Ndermarrja publike Pallati i Rinisë se Sporteve ka vepruar drejtë kur e ka njoftuar ankuesin se me datë 08.11.2025, nuk mund ta shfrytëzojnë sallën e sporteve të Pallati i Rinisë në Prishtinë, për mbajtjen e tubimit publik, për fushatën zgjedhore, sepse në bazë të rregullores se brendshme të kësaj ndërmarrje publike nuk lejohen të zhvillohen dy aktivitete në të njëjten kohë, në rastin konkret ndërmarrja publike ka dhënë përparësi organizatorit të aktivitetit për Turneun Ndërkombëtar "Adem Jashari" në xhudo", i cili ka dorëzuar kërkesën i pari, dhe ta refuzojë kërkesën që është paraqitur nga subjekti politik LVV.

Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme LZP, neni 44 paragrafi 2 përcakton se: *Mosmarrëveshjet në lidhje me mbajtjen e ndonjë ngjarje politike në vendet publike mund të shqyrtohen dhe të zgjidhen nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*”.

Nga provat në shkresat e lëndës konstatohet se Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje me datë 30.10.2025 për mes email-it, i është drejtuar me kërkesë Ndërmarrjes publike “Pallati i Rinisë dhe Sporteve” për shfrytëzimin e sallës së sporteve në Pallatin e rinisë me datë 8 Nëntor.

Në përgjigjen e Ndërmarrjes publike “Pallati i Rinisë dhe Sporteve” të datës 30.10.2025 drejtuar Subjektit Politik Vetëvendosje ndër të tjera thuhet se “ *Ju njoftoj se kam pranuar kërkesën tuaj për mbajtjen e aktivitetit partiak. Megjithatë, ju informoi se salla me datë 8 nëntor është e zënë, pasi në atë ditë zhvillohet Turneu Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Xhudo*”.

Në nenin 4 par.2 të Rregullores Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës dhe Deklarimin Financiar në mënyrë decitive thuhet se : “*Subjektet politike të certifikuara, mund të mbajnë tubimet në hapësirat publike, në institucionet arsimore, sportive dhe kulturore, ku nuk pengohet puna e rregullt e tyre dhe pasi që kjo të lejohet nga institucioni përkatës dhe KKZ*”.

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, si dhe nenit 4 par.2 të Rregullores Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës dhe Deklarimin Financiar fillimisht subjekti politik LVV është nevojitet të marrë pëlqim nga ndërmarrja publike Pallati i Rinisë dhe Sporteve, lidhur me shfrytëzimin e sallës së sporteve, për mbajtjen e aktivitetit të fushatës zgjedhore, e mëpastaj të parashtroi kërkesë në institucionin kompetent për lejimin e mbajtjes së tubimit në rastin konkret KKZ-KQZ, andaj lidhur me këtë, dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës konstatohet se Klubi i Xhudos Polici - Prishtinë ka paraqitur kërkesë i pari në Komunën e Prishtinës me datë 07.10.2025 për mbajtjen e Turneut Ndërkombëtar të Xhudos “Adem Jashari” gjithëditor për datën 08.11.2025, ndërsa parashtresuesi i ankesës ka paraqitë kërkesë për mbajtjen e Tubimit zgjedhor me datë 30.10.2025, për datën 08.11.2025, andaj parashtresuesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenin 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZLAnr.367/2025 datë 05.11.2025

**Kryesues i panelit,
Bujar Muzaqi**



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.